



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 01

Prishtinë, më 23.12.2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Melihate Termkolli dhe Milena Miliqeviq.

**Mungoi:** Jakup Krasniqi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Qëndresa Mrasori – KDI, Liridon Sadiku – IKPZH, Edita Kusari dhe Mark Hough – USAID/EROL, Agon Gashi – PILPG, Saniye Jusufi – Kosova Live, Albulena Merjo dhe Lekë Batalli – GLPS.

**Nga Stafi i Komisionit:** Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konstituimi i Komisionit;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetarja** konstatoi se rendi ditës miratohet pa ndryshime.

**Kryetarja** i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe pjesëmarrësit e tjerë. Ajo i njoftoi me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-005 të datës 18 dhjetor 2014 lidhur me përbërjen e Komisionit. Ajo në pika të shkurta i njoftoi anëtarët me fushëveprimin e Komisionit, si dhe ndryshimet që kanë ndodhur, ku është përfshirë edhe Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe Agjencina Kundër Korrupsionit, andaj brenda fushëveprimit të Komisionit do të shikohet mënyra e gjetjes së mundësive lidhur me shpërndarjen e punës.

**Selvije Halimi** i përshëndeti të pranishmit dhe anëtarët e Komisionit, dhe tha se tashmë jam e njoftuar me rolin e këtij Komisioni pasi që isha anëtare edhe në legjislaturën e tretë dhe shpresoj që ajo frymë e bashkëpunimit të jetë prezent edhe gjatë kësaj legjislature. Si anëtarë i dimë përgjegjësit tona konform rregullores së punës dhe në veçanti ajo foli për rolin që duhet të këtë komisioni në raport me Agjencinë Kundër Korrupsionit.

**Armend Zemaj** në mbledhjen e parë tha se ne duhet dakordohemi për disa çështje që më tepër janë procedurale dhe të mbarëvajtjes së punës së Komisionit. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që Komisioni për Legjislacion është komisioni kryesor i Kuvendit duke marrë parasysh natyrën e punës. Puna në këtë Komision determinon pothuajse aktivitetin e gjithmbarshëm që vjen nga Qeveria edhe nga Kuvendi. Në vazhdim tha se Kryesia e Kuvendit, ndoshta për shkak të ngarkesave dhe procedurave të përshpejtuara, e ka rritur emërtimin e këtij Komisioni edhe pse nuk ka diçka të keqe, sepse ne edhe ashtu e kemi mbikëqyrë punën e kësaj Agjencie në vazhdimësi.

*Lidhur me këtë pikë Komisioni nxori këtë:*

## **PËRFUNDIM**

2. U konstitua Komisioni në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-005, të datës 18 dhjetor 2014.

### **3. Të ndryshme.**

**Kryetarja** kërkoi nga anëtarët që të japin mendimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Komision pasi ka propozime të ndryshme. Si mundësi është që të formohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore dhe mundësia tjetër, kjo të bëhet në nivel të grupeve punuese.

**Armend Zemaj** në fjalën e tij të serishme propozoi që të formohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, nga radha e anëtarëve të Komisionit, ku grupet parlamentare të propozojnë nga një anëtar për nënkomisionin, që sipas nevojës do të organizojë takime dhe do të merret ekskluzivisht me çështjet e rregullores, kjo është më praktike. Sepse siç e dini shumë

shpejt do të këtë nevojë që të bëhen ndryshime në rregulloren e punës së Kuvendit, pasi që rregullorja e vjetër është parë që ka shkaktuar shumë probleme në zbatim.

**Melihate Termkolli** i përshëndeti të pranishmit dhe anëtarët e Komisionit dhe u pajtua me parafolësit që është Komisioni më volumin më të madh të punës në Kuvend, bashkë me Komisionin për Buxhet dhe Financa, e kjo kërkon një seriozitet të madh në punë. Unë isha pjesë e këtij Komisioni edhe në mandatin e parë dhe jam e vetëdijshme që nevojitet një përgatitje e mirë për punët që na presin. U pajtua me parafolësin që të kemi një nënkomision për faktin që sipas të gjitha parashikimeve do të kemi ndryshim të rregullores së punës. Kjo do të ishte më praktike sepse nuk kemi nevojë të jemi në përbërje të plotë si Komision, pasi shqyrtimi mund të jetë punë e përditshme. Kurse duke folur për Agjencinë Kundër Korrupsionit tha se nuk besoj që Komisioni do të arrijë të bëjë mbikëqyrje në kuptimin e plotë të fjalës, mund të bëjmë monitorim, por mbikëqyrje do të jetë problem për shkak të natyrës që e ka.

**Selviqe Halimi** e përkrahu idenë që të formohet një nënkomision që do të merret me rregulloren e Kuvendit. Mirëpo, sipas përvojës, e dimë që gjithçka që punohen në nënkomision do t'i nënshtrohet vendimit të Komisionit. Andaj nënkomisionet dhe grupet punuese janë punë më praktike për të ardhur deri te një përfundim. Kurse lidhur me mbikëqyrjen e agjencisë tha se duhet që secili nga ne ta mendojmë një modalitet, se si të bëhet kjo mbikëqyrje.

**Agim Aliu** i përshëndeti të pranishmit dhe anëtarët e Komisionit dhe ju uroi punë të mbarë. Tha se ky Komision është nga më të rëndësishmit në Kuvend dhe roli ynë do të jetë dominant dhe përkushtimi ynë duhet të ishte konsistenca e ligjeve, e akteve juridike me të cilat do të merremi. Nuk do të ishte detyra jonë e kryer nëse secila nga legjislaturat pasuese do t'i hynte për së dyti punës tonë. Duke folur për formimin e nënkomisionit tha se në parim nuk jam kundër, por nga përvoja që ne kemi, zakonisht për të mos u bërë punë, janë formuar nënkomisione, pasi që të gjitha ato ndryshime do t'i nënshtrohen edhe një debati të dytë në Komision dhe mund të mbingarkohemi.

*Pas diskutimeve Komisioni vendosi që për formimin e nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të diskutohet edhe në një mbledhje të radhës.*

Po ashtu u vendos që mbledhjet e Komisionit parimisht të mbahen çdo të hënë, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja Komisionit  
**Albulena Haxhiu**

---